



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 714 Prot.

Tiranë, më 04.072016

VENDIM Nr. 72, datë 28.06.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 8 të datës 28.06.2016, pasi shqyrtoi Informacionin mbi verifikimin në terren, në kuadër të projektit "*Pikë e shitjes me pakicë të karburanteve në rrugën "Reshit Petrela" Tiranë*,-subjekti Drita Bregu, realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik,

VENDOSI:

1. Të miratojë Informacionin mbi verifikimin në terren, në kuadër të projektit "*Pikë e shitjes me pakicë të karburanteve në rrugën "Reshit Petrela" Tiranë*,-subjekti Drita Bregu, realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik.
2. Në rast se gjatë zbatimit të punimeve identifikohen gjetje arkeologjike, subjekti zbatues duhet të ndërpresë menjëherë punimet dhe të njoftojë Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Durrës dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTER



SEKRETARI I KKA

RUDINA ZOTO